

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura 2021

**UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE
SESIONI I**

LËNDA: QYTETARI-PSIKOLOGJI
Gjinnazi

Varianti A

Udhëzime të Përgjithshme

Në testin e qytetarisë dhe psikologjisë përdoren dy lloje pyetjesh, të cilat vlerësojnë kompetencat e të nxëniet për secilin nxënës. Një nga llojet është pyetja me alternativa, ku nxënësit do të zgjedhin atë alternativë që i përgjigjet pyetjes. Çdo pyetje e këtij lloji ka një përgjigje të vetme të saktë. Përgjigjet e pyetjeve me alternativa do të vlerësohen në mënyrë elektronike.

Lloji tjetër i pyetjeve është ai me shtjellim, ku nxënësi e shkruan përgjigjen në hapësirën e përcaktuar në test. Këto pyetje vlerësohen nga vlerësues, të cilët do të përdorin udhëzimet e pikëzimit të përshkruara në vijim të këtij manuali.

Qëllimi i këtij materiali është të sigurojë për vlerësuesit informacionin dhe udhëzimet për shpërndarjen e pikëve, të nevojshme për të caktuar në mënyrë të besueshme dhe të vlefshme vlerësimin e përgjigjeve të secilit nxënës.

Secila prej pyetjeve me shtjellim ka një vlerë pikësh prej 1 (një), 2 (dy) ose 3 (tre) pikë, në varësi të thellësisë së të kuptuarit ose shkallës së mbështetjes së argumentit që kërkon pyetja.

Udhëzuesi i pikëzimit përshkruan aspekte të veçanta të përgjigjes për çdo pyetje. Secila pyetje e testit ka udhëzuesin e vet, të përshtatur për elemente specifike të saj. Megjithatë ekzistojnë disa pika të përbashkëta tek të gjithë udhëzuesit. Për shembull, niveli më i ulët i pikëve, në secilin udhëzues, është 0 pikë. Në këtë rast përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi nuk ka kuptuar një aspekt të caktuar të pyetjes. Përgjigjet që marrin një vlerësim me 0 pikë, mund tregojnë se pyetja është kuptuar keq, ose ato përfshijnë informacione aq të paqarta, sa vendosja e një pike më të lartë nuk mund të justifikohet.

Në test ka pyetje ku nxënësit do të përgjigjen në mënyra të ndryshme. Prandaj, do të ishte e papërshtatshme që të vendoset në udhëzues një përgjigje specifike, unike, që pritet të japin në test të gjithë nxënësit. Është përgjegjësia e vlerësuesit dhe më pas e komisionit të vlerësimit, që të marrë parasysh përgjigjen që nxënësi ka dhënë, dhe ta vlerësojë atë si të plotë, të pjesshme apo të pasaktë.

Në testin e qytetarisë dhe psikologjisë idetë e dhëna nga nxënësit dhe larmia e interpretimeve që ata sjellin për secilën pyetje, çon në shumë përgjigje të paparashikueshme. Udhëzuesi i pikëzimit dhe shembujt e dhënë në të duhet të jenë gjithmonë baza për secilin vendim që komisioni i vlerësimit do të japë. Megjithëse ne i inkurajojmë vlerësuesit që t'i lexojnë përgjigjet e nxënësve në mënyrë mbështetëse, domethënë që mund të lejojnë gabime të vogla ose mungesë qartësie, është e domosdoshme që vlerësuesit të mos interpretojnë mbi përgjigjet e dhëna nga nxënësit. Ata nuk duhet të supozojnë se çfarë donte të thoshte nxënësi në përgjigjen e tij. Vlerësuesit duhet ta vlerësojnë secilën përgjigje të nxënësit sipas përgjigjes konkrete që ka dhënë ai. Në fund të fundit, kjo është mënyra më e drejtë, e besueshme dhe e vlefshme për pikëzimin e përgjigjeve të nxënësve për këto lloje pyetjesh.

Qytetari

Qytetari-Psikologji- Sesioni I		QYTETARI-PSIKOLOGJI
Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit		Varianti A
Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetje 11	A	1 pikë
Pyetja 13	D	1 pikë
Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë
Pyetja 21	A	1 pikë
Pyetja 2		1 pikë
Model përgjigjeje		

Ligji ka funksion parandalues të dëmeve dhe konflikteve njerëzore. Parashikohen raste për të parandaluar abuzimet.

1 pikë nëse përcakton funksionin parandalues të dëmeve dhe konflikteve njerëzore.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 3	2 pikë
Model përgjigjeje	
<ul style="list-style-type: none"> Një njeri mund të shkaktojë dëm të tjerëve me veprimet e tij dhe për këtë mban përgjegjësi penale, civile ose administrative. Mban përgjegjësi penale kur për shembull, kryen një krim. Ka përgjegjësi civile në rast se për shembull, shkel të drejtën e dikujt për t'u informuar. Kur nuk zbatohet ligji çenohen ekuilibrat e bashkëjetesës në shoqëri. Ka edhe penalitete për rastet e mosveprimit, të tilla si për shembull: mospagesa e taksave, mosdhënia e ndihmës së parë në një aksident, mosbashkëpunimi me strukturat e rendit për kapjen e një shkelësi të ligjit etj. 	
2 pikë nëse argumenton dëmet për veprimet dhe mosveprimet;	
OSE	
1 pikë nëse argumenton dëmet për veprimet OSE vetëm dëmet për mosveprimet.	
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.	

Pyetja 4	2 pikë
Model përgjigjeje	
<p>a) Qeverisje e popullit-pushteti buron nga populli, i cili është bartës i <i>sovrانيتit</i>. "Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit shqiptar" (Neni 2).</p> <p>b) Qeverisje nga populli -</p> <ul style="list-style-type: none"> populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij populli e ushtron sovranitetin drejtpërsëdrejti (<i>referendumi</i>). (Neni2). Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike. (Neni 1). <i>E drejta universale e votës</i>: Kjo u jep qytetarëve të rritur, burra e gra, të drejtën për të votuar për partitë ose kandidatët në zgjedhjet parlamentare. <p>c) Qeverisje për popullin -pushteti ushtrohet për t'i shërbyer interesave të popullit, për shembull parimet si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij</i>; <i>Dinjteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e individit</i>; <i>Drejhtësia shoqërore</i>; <i>Rendi kushtetues</i>; <i>Pluralizmi</i>; 	

- Identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare etj.

2 pikë nëse përcakton dy nga parimet e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse përcakton një nga parimet e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 6

2 pikë

Model përgjigjeje

- Roli i shtetit të mirëqenies sociale është të ofroj siguri, garantim të të drejtave, mbështetje për të garantuar minimumin jetik e shërbime sociale;
Harton politika sipas nevojave të grupeve të veçanta, për shembull për personat me aftësi ndryshe (P.A.K).
- Kjo është një e drejtë e brezit të dytë, lidhet me të drejtat sociale;

2 pikë nëse shpjegon rolin social të shtetit ose politika për personat me aftësi ndryshe (P.A.K) dhe brezin e të drejtës.

OSE

1 pikë nëse shpjegon vetëm rolin e shtetit të mirëqenies sociale **OSE** nëse shpjegon vetëm brezin që i përket kjo e drejtë.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetje 7

2 pikë

Model përgjigjeje

- Kufizimi i ligjeve ka rëndësi kur realizohet në emër të rendit publik.
- Ky kufizim realizohet për të parandaluar krime dhe për të garantuar të drejta të tjera të njeriut. Ky kufizim i të drejtave realizohet për situata të veçanta siç mund të përmendim emergjencat civile, sulmet terroriste etj.

2 pikë nëse argumenton kufizimin në emër të rendit publik **DHE** parandalimin e krimeve, garantimin e të drejtave të tjera;

OSE

1 pikë nëse argumenton vetëm rëndësinë e garantimit të rendit publik **OSE** argumenton vetëm parandalimin e krimeve, e garantimin e të drejtave të tjera.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 8

2 pikë

Model përgjigjeje:

Qeverisja demokratike e nxënësve të shkollës i ndihmon ata:

- të njohin më mirë të drejtat, por dhe të zbatojnë rregullat dhe ligjet;
- të mësojnë si të ndikojnë në proceset vendimmarrëse të shkollës dhe komunitetit;
- të njohin dhe të shprehin interesat dhe pikëpamjet e tyre me vetëbesim;
- të trajtojnë njëri-tjetrin me respekt të ndërsjellë;
- të zgjidhin konfliktin në rrugë dhe me mjete paqësore, domethënë të bëjnë marrëveshje dhe kompromise;
- të marrin pjesë në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve;
- të marrin përsipër përgjegjësinë për vendimet dhe zgjedhjet e tyre;
- të marrin iniciativa, duke përdorur mendimin kritik dhe krijues;
- të mësojnë të drejtën për t'u dëgjuar dhe të dëgjuar të tjerët;
- të fitojnë vetëvlerësim duke dhënë kontribut për klasën dhe komunitetin e shkollës së tyre;
- të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të klasës/shkollës;
- të përfaqësojnë mendimet e klasës në bordin drejtues dhe stafin pedagogjik;
- të bëjnë propozime dhe organizojnë aktivitete në klasë/shkollë;
- të fitojnë aftësi sociale dhe sjellje morale të përgjegjshme kundrejt njëri-tjetrit dhe kundrejt mësuesve;
- Etj.

- 2 pikë** nëse shpjegon dy nga funksionet e mësipërme;
1 pikë nëse shpjegon një nga funksionet e mësipërme;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9**1 pikë****Model përgjigjeje**

- kanë më shumë probleme shëndetësore, tregues më të lartë vdekshmërie pasi nuk janë të kujdesshëm në parandalimin parësor;
- kanë mungesë të informacionit shëndetësor;
- nuk janë të ndërgjegjësuar për problemet që sjell abuzimi me shëndetin (regjim jo i shëndetshëm, abuzim me alkoolin, substancat narkotike etj.).
- në disa raste ndodh që personat me nivel të ulët edukimi të kenë të ardhura të pakta, çka mund të ndikojë që të mos trajtojnë problemet ose të mos i parandalojnë.

1 pikë nëse shpjegon një nga alternativat.**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 10****2 pikë****Model përgjigjeje**

- shëndeti konsiderohet një mirëqenie fizike, sociale dhe psikologjike e cila duhet të mbrohet me ligj pasi konsiderohet një e mirë publike;
- shteti përcakton politikat publike për parandalimin e sëmundjeve, për të mbrojtur popullatën nga sëmundje të ndryshme si për shembull sëmundje infektive;
- nëse shëndeti nuk do të konsiderohej një e drejtë, nuk do të kishim angazhim shtetëror për vëmendje ndaj politikave shëndetësore e si rrjedhojë mund të përballëshim me vështirësi që do të ndikonin në shkollim, punësim, do të kishim pasoja financiare etj.
- shteti duhet të kujdeset për mirëqenien e popullatës së tij si pjesë e "kontratës sociale", në aspektin moral, social, ligjor dhe financiar kërkon të ketë një popullsi të shëndetshme. Shteti kontribuon me politika dhe shërbime për mirëqenien e popullatës, është në shërbim të saj, por edhe në aspektin financiar kërkon një popullsi ekonomikisht aktive.

2 pikë nëse argumenton bazuar në alternativat e mësipërme.**OSE****1 pikë** nëse argumenton në mënyrë të pjesshme bazuar në alternativat e mësipërme.**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 12****2 pikë****Model përgjigjeje**

- Kursimi i burimeve energjitike;
- Përdorim i llambave që kursejnë energjinë;
- Përdorimi i transportit urban në vend të makinave personale, ose makinave të vjetra që janë më ndotëse;
- Përdorimi i biçikletave si mënyra me e mirë për të mbrojtur mjedisin;
- Përmes procesit të tre R-ve, riciklim, ripërdorim, reduktim;
- Mbjellja e pemëve;
- Mbjellja pastër e mjedisit;
- Etj.

2 pikë nëse shpjegon dy nga angazhimet e mësipërme në mbrojtje të mjedisit;**OSE**

1 pikë nëse shpjegon një nga angazhimet e mësipërme në mbrojtje të mjedisit;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15

2 pikë

Model përgjigjeje

- Jo, sepse kushtetuta (de juro) e njeh të drejtën për punë, por nuk garanton (de facto) punësimin. Pra nuk mund të themi se shteti nuk po e garanton të drejtën për punë.
- Shteti gjen mekanizma për të mundësuar punësimin e punëkërkuësve të papunë, përmes Shërbimit Kombëtar të Punësimi dhe Zyrate të Punës. Shteti i propozon punëkërkuësit të papunë të regjistruar në Zyrat e Punës, alternativa pune në përputhje me profilin. Punëkërkuësit të papunë shteti i ofron kualifikim për të gjetur veten në tregun e punës.

2 pikë nëse analizon rolin e shtetit në punësim DHE mekanizmat e tij për të mundësuar punësimin;
OSE

1 pikë nëse analizon vetëm rolin e shtetit në punësim OSE vetëm mekanizmat e tij për të mundësuar punësimin.

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19

2 pikë

Model përgjigjeje

- Liria e shprehjes pa kushtëzime, ndikon në zhvillimin e gazetarisë amatoreske që mund të shkaktojë probleme deontologjike (etike);
- Liria e medias pa kushtëzim mund të prodhoj lajme të rreme dhe ndikon negativisht në shoqëri;
- Liria e medias pa kushtëzime mund të prodhoj lajme që çënojnë sigurinë dhe rendin publik;
- Liria e medias pa kushtëzime mund të çënoj të drejtën e të dhënave konfidenciale, e jetës private;
- Etj.

2 pikë nëse shpjegon dy nga problemet e lirisë së medias pa kushtëzime;
OSE

1 pikë nëse shpjegon një nga problemet e lirisë së medias pa kushtëzime;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Psikologji

Pyetja 22	C	1 pikë
Pyetja 23	C	1 pikë
Pyetja 25	C	1 pikë
Pyetja 27	C	1 pikë
Pyetja 28	C	1 pikë
Pyetja 31	D	1 pikë
Pyetja 32	C	1 pikë
Pyetja 34	D	1 pikë
Pyetja 37	D	1 pikë
Pyetja 38	A	1 pikë

Pyetja 24
Model përgjigjeje **2 pikë**

Vlerëson rëndësinë e psikologut shkollor në disa drejtime:

- Trajtojnë probleme të nxënësve në të nxënit (vështirësi për të lexuar, shkruar, etj) dhe përshtatjes në shkollë (përshtatje në shkollë të re apo në një cikël të ri studimi). Japin këshillat dhe dëgjojnë problematikat e nxënësve në mënyrë që të tejkalojnë këto sfida;
- Trajtojnë problemet e nxënësve që kanë motivim të ulët në shkollë dhe rezultate të ulta. Përpiqen të gjejnë teknikat e duhura për të nxitur motivimin;
- Trajtojnë problemet e nxënësve me vetëvlerësim të ulët, që shpesh bëhet shkak për performancë të ulët në mësim, ankth, stres, depresion, çrregullime në të ngrënë, vetëlëndim etj;
- Trajtojnë probleme mes nxënësve si dhuna, bullizmi etj;
- Diagnostifikojnë dhe trajtojnë probleme emocionale me të cilat përballen nxënësit duke i këshilluar ata për të kapërcyer problemet.
- Etj.

2 pikë nëse vlerëson rolin e psikologut përmes dy shembujve;

OSE

1 pikë nëse vlerëson vetëm rolin e psikologut **OSE** nëse jep vetëm një shembull;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26
Model përgjigjeje **2 pikë**

Mënyrat për të përballuar stresin gjatë pandemisë nga Covid 19:

- Hartimi i një planveprimi për zgjidhjen e problemit dhe përballimin e stresit që e shkakton atë. Jepini përgjigje pyetjeve: Çfarë më shqetëson mua? Si po e përballoj tani? Si e vura në zbatim planin tim? Çfarë do të bëj më tej?
- Të qenit optimist për të ardhmen;
- Të qenit i sigurt për marrjen e masave mbrojtëse;
- Konsumimi i ushqimit të freskët dhe merrja me veprimtari fizike, sport etj;
- Kalimi i kohës me familjarët;
- Dëgjimi i muzikës së mirë;
- Ëndërrimi dhe udhëtimi përmes imagjinatës;
- Zhvillimi i talenteve dhe prirjeve personale;
- Përqendrimi te gjërat që doni më shumë, për të larguar mendjen;
- Planifikimi i të ardhmes që dëshironi;
- Vlerësimi i sukseseve të arritura dhe ecja përpara me plane të reja;

- Gjenerali pika mbështetëse të qëndrueshme dhe njerëz pozitiv që ju përkrahin;
- Kërkonin ndihmën e më të rriturve ose specialistëve të shëndetit, nëse stresi rritet;
- Etj.

2 pikë nëse tregon dy nga hapat e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse tregon një nga hapat e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29

2 pikë

Model përgjigjeje

Nevojat e personave, sipas Mazllout:

a) **Nevoja për vlerësim:** në këtë shkallë të hierarkisë njerëzit kërkojnë vlerësimin e të tjerëve, të të afërmeve, miqve, kolegëve, grupit shoqëror të cilit i përket. Individit kërkon vlerësim për vlerat dhe arritjet e tij në jetë, në profesion, karrierë ose në jetën personale. Nëse nuk e plotëson këtë nevojë, ndjehet i parëndësishëm dhe pa vlerë.

Nga ana tjetër, individit ka nevojë të ketë një vlerësim të vetvetes, pra vetëvlerësim, të njohë vetveten, të ndihet i sigurt dhe i vlefshëm brenda shoqërisë. Nëse njeriu nuk arrin ta plotësojë këtë nevojë, lindin ndjenja të pakënaqësisë dhe vetëvlerësimi të ulët, njerëzit e konsiderojnë veten inferiorë ndaj të tjerëve.

b) **Nevoja për vetaktualizim:** në këtë shkallë, që është dhe maja e piramidës, njeriu kërkon të arrijë majat e karrierës, të realizohet në profesion, të jetë i suksesshëm, të gjejë sfida të reja për t'i kapërcyer me sukses, me guxim dhe në mënyrë inovatore dhe të pavarur, pavarësisht se çfarë të tjerët mendojnë për synimet e tyre. Janë kurioz dhe vizionar, aktiv dhe në kërkim të së resë. Mbajnë përgjegjësi, janë realistë në gjykime, racionalë, praktikë dhe të vendosur, spontanë dhe të hapur. Janë tolerantë dhe nuk paragjykojnë, janë krijues dhe miqësorë, prirjen t'i ndihmojnë të tjerët.

2 pikë nëse shpjegon dy nga nevojat e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse shpjegon një nga nevojat e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30

2 pikë

Model përgjigjeje

a) **Faktori biologjik**

- Emocionet lindin bashkë me njeriun. Çdo individ është i aftë të ndjejë emocione dhe ti shprehë ato. Psikologët besojnë se emocionet parësore dhe mënyra e shprehjes së tyre kanë bazë biologjike, sepse vihen re në të gjitha kulturat dhe njerëzit.

- Emocionet mund të shprehin në mënyrë instiktive, pa fjalë, përmes mimikës së fytyrës, gjesteve, pozicionit të trupit etj. Bebet që në muajt e parë të jetës mund të shprehin emocionet parësore përmes mimikës. Kjo tregon se janë të lindura të njeriut.

- Studimet kanë treguar se njerëz të kulturave të ndryshme i shprehin dhe i interpretojnë emocionet në mënyrë të ngjashme, si për shembull kur ndjejnë frikë, gëzim, habi etj. Pra, kanë karakter universal, biologjik.


- Aspekti biologjik, duket edhe në intesitetin e shprehjes, që varet shumë nga natyra emocionale dhe temperamentit i njeriut.

b) **Modeli kulturor**

- Shprehja e emocioneve kushtëzohet shpesh nga rregullat e kulturës përkatëse, prandaj ndodhin edhe keqkuptime kur kapërcejmë kufijtë e kulturave të ndryshme. Anëtarët e së njëjtës kulturë vendosin rregulla të shprehjes së emocioneve, që duhen respektuar nga të gjithë. Për shembull nuk mund të qeshësh në një funeral ose rregullat e të ngrënit në tavolinë etj.

- Disa kultura janë më të përmbajtura në shprehjen e emocioneve në krahasim me të tjerët, si për shembull japonezët nuk e shfaqin hidhërimin sikurse bëjnë europianët, por mbajnë një buzëqeshje mirësjelljeje në fytyrë etj.

- Në disa kultura shprehja e ndjenjave dhe emocioneve, sidomos me fjalë, konsiderohet dobësi, në disa të tjera bëhet hapur.



- Disa gjendja emocionale shprehen përmes gjesteve të ndryshme si të pranimit ose mospranimit, që ndryshojnë sipas kulturave. Kështu, ngritja e gishtit të madh për amerikanët, shenja OK, nënkupton dakordësi, ndërsa për shqiptarët shpreh refuzim.

2 pikë nëse shpjegon dy faktorë që ndikojnë në sjelljen emocionale;

OSE

1 pikë nëse shpjegon një faktor që ndikon në sjelljen emocionale;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33

2 pikë

Model përgjigjeje

- Një nxënës i shkollës fillore sipas Kohlberg është në fazën e parë të zhvillimit moral e pjesërisht në fazën e dytë.
- Sjellja përcaktohet nga frika që ka për pasojat nga veprimet e kryera. Ata prirjen të kufizojnë sjelljet nga frika prej ndëshkimit, duke u orientuar të realizojnë sjellje të cilat kanë miratim në shoqëri.

2 pikë nëse përcakton fazën **DHE** jep shpjegimin;

OSE

1 pikë nëse përcakton vetëm fazën **OSE** vetëm shpjegimin;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 35

2 pikë

Model përgjigjeje

Format e të mësuarit kognitiv:

- të mësuarit e thjeshtë/mekanik;
- të mësuarit latent;
- të mësuarit zbulues.

2 pikë nëse rendit dy nga format e mësipërme të të mësuarit kognitiv;

OSE

1 pikë nëse rendit një nga format e mësipërme të të mësuarit kognitiv;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 36

2 pikë

Model përgjigjeje

Përmirësimi i kujtesës

a) Organizimi i materialit:

- Seleksionimi i informacionit: mbajtja mend e ideve më të rëndësishme të infos, për çdo mësim, kapitull etj.
- Organizimi i infos, sipas llojit, klasës, hierarkisë etj.
- Studimi i informacionit sipas rastiit, të tërin ose në pjesë të vogla, kur është i gjatë dhe i ndërlikuar.
- Etj.

b) Përqëndrimi

- Përqëndrimi, sepse vëmendja është porta nga hyn informacioni në kujtesë.

c) Menaxhimi i kohës:

- Shpërndarja e studimit në kohë, në seanca jo shumë të gjata;
- Kombinimi i mësimit me pushime aktive në mes, për të qenë më efikasë;
- Mos lënia e studimit për ditët e fundit. Info kërkon të paktën 5 ditë që të përvetësohet;
- Etj.

d) Testimi i vetes:

- Lidhja e infos së mësuar me infon e mëparshme;

- Riprodhimi;
- Përsëritja e vazhdueshme e materialit të mësuar;
- Përdorimi i imagjinatës dhe shqisave: thënia me zë ose me mendje, e materialit të mësuar;
- Etj.

e) Përdorimi i mnemonikave: Teknika e fjalëve lidhëse; Përdorimi i sa më shumë imazheve dhe pikturave mendore; Asosacione ndërmjet ideve, fakteve, objekteve etj.; Teknika e lidhjes së infos me vende të caktuara; Teknika e shkronjave të para.

2 pikë nëse tregon dy nga metodat e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse tregon një nga metodat e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 39

2 pikë

Model përgjigjeje

Disa nga mënyrat për vlerësimin e personalitetit janë:

- a) **Vëzhgimi i individit** – jep mundësi që të studiohet sjellja e dukshme e tij, kur ai nuk e di që po vëzhgohet. Kjo sjell rezultate të mira, sepse ne mund ta njohim këtë person në situata të ndryshme jetësore, pasi ajo është e pandikuar nga faktorë modifikues. Zakonisht, njihen më mirë njerëzit që kemi patur mundësi t'i vëzhgojmë në situata të jetës së përditshme. Megjithatë, jo gjithmonë njerëzit shprehin ose veprojnë sipas asaj që mendojnë vërtet. Si rezultat, kjo metodë është e kufizuar dhe kombinohet me metoda të tjera të studimit.
- b) **Testet projektive** – janë mënyrë shumë e përhapur për të vlerësuar personalitetin e njerëzve. Informacioni për personalitetin e individit merret përmes mënyrës se si ai projektin figura të ndryshme dhe të paqarta. Individit i shfaqen kartela me figura njerëzish ose njolla boje dhe ai duhet të thotë se çfarë sheh në to. Ajo që personi thotë se sheh, përbën një projektion të asaj që ka brenda vetes. Ky informacion i shërben psikologëve për të vlerësuar personalitetin e individit. Edhe kjo metodë ka kufizimet e veta dhe nuk mund t'i zbulojë të gjitha anët e personalitetit.

2 pikë nëse përshkruan dy nga metodat e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse përshkruan një nga metodat e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 40

2 pikë

Model përgjigjeje

Shkaqet pse një individ shfaq sjelle konformiste:

- a) **Presioni i shoqërisë:** Shoqëria vendos norma, që janë trashëguar brez pas brezi dhe mësohen që në moshë të vogël. Ato mbështeten nga familja, shkolla dhe shoqëria, të cilat bëjnë presion që këto rregulla të zbatohen nga të gjithë. Përgjithësisht, shoqëria nuk i inkurajon ata që devijojnë nga modelet e pranuar, madje opinioni i dënon. Njerëzit kanë frikë nga refuzimi ose dënimi i të tjerëve, presin respekt, pranim dhe prandaj përpiqen të mos jenë ndryshe nga shumica, duke u sjellë konform rregullave dhe duke ndjekur modelin e pranuar nga të shumica;
- b) **Mungesa e iniciativës dhe vetëbesimit:** sjellja konformiste varet shumë edhe tiparet e personalitetit të njeriut. Këtyre individëve iu mungon vetëbesimi dhe iniciativa, që duket në faktin se ata:
- Kërkojnë që të tjerët t'i duan dhe t'i respektojnë me çdo kusht dhe në çdo rast;
 - Nuk duan të prishin marrëdhënien me grupin;
 - Duan t'i qëndrojnë besnik rregullave dhe normave të vendosura nga shoqëria, janë tradicional;
 - Nuk kanë guxim të mjaftueshëm për t'iu kundërvënë të tjerëve;
 - Nuk janë tipa kreativë dhe revolucionarë që iu pëlqen ndryshimi;
 - Janë të pasigurtë në vlerat që përfaqësojnë dhe nuk luftojnë për realizimin e tyre;

- Janë të pafuqishëm për të kontrolluar jetën e tyre;
- Ndjehen më të sigurtë në grup dhe besojnë se bashkimi bën fuqinë;
- Mendojnë se të tjerët kanë më shumë të drejtë dhe binden;
- Kanë nevojë të vazhdueshme për mbështetjen dhe aprovimin e të tjerëve për të marrë vendime;
- Etj.

2 pikë nëse analizon dy nga shkaqet e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse analizon një nga shkaqet e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 41

2 pikë

Model përgjigjeje

Argumente për faktorët që ndikojnë në pabarazinë e pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe vendimmarrje:

- Modeli i familjes - Modeli tradicional dhe patriarkal i shoqërisë në edukimin gjinor, ku burri kryeson në familje, ndikon edhe në perceptimin e tyre si drejtues në qeverisje.
- Besimet dhe opinionet - Politika është konsideruar gjithmonë atribut i burrave. Megjithëse sot ka ndryshuar gjendja, gratë paragjykohe shumë më tepër se burrat në politikë dhe pjesëmarrja e tyre është më e ulët.
- Mungesa e informacionit - Bindja e gabuar se diferencat mes gjinive janë të lindura dhe se gratë janë emotive dhe më pak inteligjente sesa burrat. Atyre iu takon të kujdesen për shtëpinë dhe fëmijët, ndërsa burrave të merren me sektorët jashtë saj.
- Shkolla dhe mënyra e arsimit - djemtë inkurajohen të mendojnë në mënyrë të pavarur, të jenë aktiv dhe të shprehen hapur, ndërsa vajzat edukohen në shkolla për të qenë sa më të urta dhe të bindura. Për pasojë ato nuk e shohin veten në drejtim.
- Mediat dëmtojnë imazhin e gruas dhe krijojnë modele të gabuara sociale. Reklamojnë bukurinë fizike dhe më pak vlerat e saj në vendimmarrje;
- Mungesa e modeleve të grave politike në histori për një kohë të gjatë, për shkak të mungesës së të drejtave të saj njerëzore dhe shoqërore, ka krijuar bindjen se politika është zotësia e burrave.
- Vetë gratë humbasin sigurinë në forcat e veta, përballë sulmeve paragjykuese të opinionit.
- Feja përgjithësisht e trajton figurën e gruas më inferiore se të burrit, një krijesë që duhet të bindet dhe të jetë e nënshtruar.
- Etj.

2 pikë nëse jep dy nga argumentet e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse jep një nga argumentet e mësipërme;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.